



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 2 nënparagrafi 1) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 40 paragrafi 2 nënparagrafi nënparagrafi 11 të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt të vitit 2018, të mbajtur më datën 30.03.2018, mori këtë:

V E N D I M

Formimi i Këshillit Organizativ për Festivalin Folklorik “I këndojmë Lirisë”

I

Miratohet, vendimi për Formimin e Këshillit Organizativ për Festivalin “I Këndojmë Lirisë”, që do të mbahet më datën 6,7 dhe 8 qershor 2018.

II

Këshilli Organizativ ka këtë përbërje:

Skender Merturi-drejtor i DKRS, Besim Hoti-nenkryetari i KK të Klinës, Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Emergjente, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Inspektoratit, Elmi Berisha, Elmi Salihu, Alban Gashi, Muji Gashi, Liridon Haxhaj, Rexhë Buqani, Idriz Berisha, Ndërmarrja publike “Ambienti” Dibran Fylli, Halit Gashi, Daut Gashi, Fatmir Berisha, Grupi i Gazetareve (Agron Bojaj, Mimoza Bajraktari, Enver Maloku), përfaqësues i fshatit Qabiq, Hajdin Balaj-kryetar i veteraneve të luftës, një familjar i Mujë Krasniqit, Policia, Ilir Rraci, përfaqësues i partive politike që janë pjesë e Asamblesë komunale, Qendrim Millaku, Vlora Tafilaj, Besnik Dragaj, Ismet Musaj, Rasim Gashi, Tunë Dedaj, Zeqir Morina, Saranda Zeqaj dhe Xhevxhet Berisha.

III

Këshilli organizativ, si në pikën 1 të këtij Vendimi është kompetent për përgatitjen e punëve rreth organizimit dhe formimin e grupeve punuese për funksionalizimin sa më të mirë të këtij Festivali.

IV

Ky vendim shfuqizon vendimin 01Nr.06-2740/2016 të datës 02.06.2016.

V

Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin nga Kuvendi konform nenit 81 të LVL dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës

VI

Me këtë vendim njoftohet: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria për KRS, Shërbimi për Punë të Kuvendit, Zyra për Informim, Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-2630
Klinë, më 06.04 2018

